



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 8 paragrafët të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr. 04/L-144 dhe nenit 15.2 shkronja d të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 02 shkurt 2017, miratoi:

VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN E PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM

Neni 1

Ndryshohet përbërja e Komisionit vlerësues për dhënie e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, si vijon;

1.1.

z.Vezir Januzi, për shkak të shkuarjes në punë dhe detyra tjera të punës, zëvendësohet me znj.Florije Besholli, përfaqësuese nga Ekzekutivi i Komunës.

1.2.

z.Afrim Shabani, për shkak të shkuarjes në punë dhe detyra tjera të punës, përkatësisht dorëheqjes së parevokueshme nga pozita e këshilltarit të Kuvendit të Komunës së Podujevës, zëvendësohet me znj.Afërditë Lutfiu, përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës.

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit për themelimin e Komisionit vlerësues për dhënie e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, nr. 01-006-23423 të datës 13 mars 2014, ndërsa shfuqizon Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.01-006-45861 dt.27 maj 2014.

Neni 3

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë, përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-020/03-6012/17
Podujevë,
02 shkurt 2017



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi